

LIGJ
Nr.9712, datë 16.4.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 3 e nenit 20 “Toka dhe ndërtesat” ndryshohet si më poshtë:

“3. Dhënia me qira e ndërtesave është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve:

- a) të dhënies me qira për një periudhë jo më shumë se dy muaj;
- b) të strehimit në hotele ose vende pushimi.”.

Neni 2

Neni 22 “Banka e Shqipërisë” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22
Bankat

Furnizimi i arit nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, si dhe i bankënotave dhe i monedhave nga Banka e Shqipërisë është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 3

Pas pikës 4 të nenit 26 “Importimi i mallrave” shtohen pikat 5 e 6 me këtë përmbajtje:

“5. Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet sipas pikave 3 e 4 më lart, pa përfshirë vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së arit të përdorur si lëndë e parë përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji. 6.

Operatorët e telefonisë celulare do të vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të gjitha kartat SIM dhe numrat IMEI të aparateve celulare, që janë në përdorim në datën 1 tetor 2007. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, duke filluar nga data 1 tetor 2007, operatorët e telefonisë celulare do të ofrojnë shërbimet e tyre vetëm për numrat IMEI të aparateve celulare, për të cilat importuesit apo zotëruesit e tyre kanë ndjekur procedurën e mëposhtme:

a) importuesit e aparateve telefonike celulare, në çastin e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve fiskale pranë shërbimit doganor, duhet të deklarojnë edhe listën e numrave IMEI të aparateve të importuara;

b) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është mbi minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, ndjekin

të njëjtën procedurë si në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është nën minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë pranë shërbimit doganor një deklaratë individuale për numrin IMEI të aparatit telefonik celular.

Shërbimi doganor njofton zyrtarisht operatorët e telefonisë celulare për numrat IMEI, të deklaruar nga importuesit dhe individët, në përputhje me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike. Forma e deklarimit të numrave IMEI nga importuesit dhe individët përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 4

Pas nenit 27/1 shtohet neni 27/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/2

Furnizimi i arit të përpunuar

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, nuk përfshin vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së arit, të përdorur si lëndë e parë, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 5

Pika 8 e nenit 36 “Faturat” shfuqizohet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5287, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**